AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

# KOMUNIKATË PËR MEDIA

**Anketa e Mbeturinave të Trajtuara (AMT), 2022**

19.10.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara (AMT) për vitin 2022.

## Më shumë mbeturina të trajtuara në 2022 sesa në 2021

Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

Të dhënat e AMT 2022 tregojnë se gjithsej sasia e mbeturinave të ricikluara ka qenë 22 882 ton, sasia e mbeturinave të sterilizuara (mbeturina medicinale) ka qenë 1 245 ton. Ndërsa, gjithsej sasia e mbeturinave të trajtuara dhe të deponuara në vitin 2022 ishte 521 172 ton, ku krahasuar me të dhënat e vitit 2021, ka një rritje prej 3,0%.

**Mbeturinat e trajtuara sipas llojit për vitin 2022/t**

| Mbeturina | Deponuara | Ricikluara | Sterilizuara | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| Mbeturina spitalore | | | 1,245 | 1,245 |
| Mbeturina të letrës dhe kartonit | | 10,839 | | 10,839 |
| Mbeturina nga metali | | 3,524 | | 3,524 |
| Mbeturina nga plastika | | 8,519 | | 8,519 |
| Mbeturina nga ekonomitë familjare dhe të ngjashme | 497,045 | | | 497,045 |
| Gjithsej | 497,045 | 22,882 | 1,245 | 521,172 |

### Mbeturinat e trajtuara sipas llojit dhe trajtimit

Sasia e mbeturinave të trajtuara sipas llojit të mbeturinave dhe llojit të trajtimit, e shprehur në përqindje për vitin 2022 ishte: Mbeturinat nga letra dhe kartoni (45,0%); Mbeturinat nga plastika (35,0%); Mbeturinat nga metalet (15,0%); dhe Mbeturinat medicinale-spitalore (5,0%).

**Mbeturinat e trajtuara 2022 (%)**




## Mbeturinat e deponuara

Sasia e mbeturinave të deponuara në vitin 2022 ishte 497 045 ton, ku krahasuar me të dhënat e vitit 2021 ka një rritje prej 2,74%. Ndërsa, krahasuar sipas rajoneve, sasia më madhe e mbeturinave të deponuara ishte në deponinë sanitare në Rajonin e Prishtinës (Mirash), 168 395/ t, ose 33,9%.

**Mbeturinat e grumbulluara në deponitë e licencuara për vitin 2022/t**

| Deponitë | Gjithsej/ton | % |
|---|---|---|
| DS-Prishtinë | 168,395 | 33.9 |
| ST-Ferizaj | 28,612 | 5.8 |
| DS-Gjilan | 43,242 | 8.7 |
| DS-Mitrovicë | 52,858 | 10.6 |
| DS-Pejë | 57,655 | 11.6 |
| DS-Prizren | 128,832 | 25.9 |
| DS-Podujevë | 17,451 | 3.5 |
| Gjithsej | 497,045 | 100 |

**Mbeturinat e deponuara, 2022 (%)**



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Për më shumë informata lidhur me rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara (AMT) për vitin 2022, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Environment